



Datë: 19.05.2025

Numër protokolli: 3272/2017

A.nr.13/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari Kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2026/2022 të datës 04.04.2025 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative të pranuar me datë 08.04.2025, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.02/374/2017 të datës 27.06.2017 të parashtruar nga ankuesi R.R, kundër organit të punësimit Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në çështjen juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.05.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A02/374/2017 e datës 27.06.2017 e parashtruar nga ankuesi R.R.

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokolli 2320/2017 i datës 26.05.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendimin me numër A02/374/2017 të datës 07.08.2017 ka Hedhë poshtë si të palejuar ankesën me numër protokolli 3156/2017 të datës 27.06.2017 e parashtruar nga ankuesi R.R

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Këshillit me numër A02/374/2017 të datës 07.08.2017, ka inicuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me aktgjykimin A.nr.1605/17 të datës 09.01.2020 i pranuar në Këshill me datë 20.01.2020 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar duke anuluar vendimin e Këshillit A02/374/2017 të datës 07.08.2017 dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa me datën 09.03.2020 me numër protokoli 635/2020 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Këshillit me numër A02/374/2017 të datës 07.08.2017 ka inicuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me aktgjykimin A.nr.2026/2022 të datës 04.04.2025 i pranuar në Këshill me datë 08.04.2025 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke anuluar aktin administrativ njoftimin Nr.ref.621/2020 të datës 09.03.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke detyruar Këshillin që në afatin prej 30 ditësh me vendim të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 27.06.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 3156/2025 të datës 27.06.2017 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykim me numër A.nr.2026/2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 04.04.2024 i pranuar në Këshill me datë 08.04.2025; Përgjigje në padi me numër protokoli 338/2023 i datës 13.01.2023; Aktvendim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 09.12.2022; Padi e R.R. drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 17.08.2017; Letërnjoftim i R.R.; Njoftim i KPMSHCK me numër protokoli 635/2020 i datës 09.03.2020; Fletëkthesë e datës 21.07.2022; Vendim me numër protokoli 2320/2017 i datës 26.05.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; Vendim i KPMSHCK me numër A02/374/2017 i datës 07.08.2017; Aktgjykim me numër A.nr.1605/17 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 09.01.2020 i pranuar në Këshill me datë 20.01.2020; Njoftim nga R.R. me numër protokoli 621/2020 i datës 06.03.2020; Përgjigje në padi me numër protokoli 1389/2019 i datës 14.03.2019; Aktvendim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 19.02.2019; Padi e R.R. drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 25.09.2017; Fletëkthesë e datës 25.08.2017; Vendimi me nr.97/2012 i datës 16.07.2012; Vendimi me nr.82/2011 i datës 26.08.2011; Vendimi i datës 11.03.2010; Vendimi i datës 06.05.2008; Vlerësimi final i projekteve konkurruese sipas përzgjedhjes së jurisë 2012 i datës 25.07.2012; Projektet konkurruese në konkursin

e vitit 2012 me raportin pas shqyrtimit të dokumentacionit datë 15.07.2012 dhe 16.07.2012; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit bija minatorit i datës 09.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit korniza e gjelber i datës 11.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit shiu i nëndorit i datës 01.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit minutat e ligë i datës 19.05.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit shkolla e maleve i datës 13.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit teuta më nuk jeton këtu i datës 10.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit mot i keq për dashuri i datës 30.05.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit trip i keq pa datë; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit protesta e heshtur i datës 16.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit battery low i datës 18.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit dashuria për jetë i datës 26.05.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit burgu shtëpiak i datës 10.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit hakmarrja i datës 13.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit shahu pa datë; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit gurët në valixhe i datës 10.02.2011; Paralogaria financiare e projektit titulli projektit fillimi fundit i datës 07.06.2011; Konstruksioni financiar i projektit titulli projektit Eva i datës 16.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit gjysem goje i datës 18.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit toka i datës 16.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit rubikoni titull pune i datës 18.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit qyteti muze prizren i datës 13.06.2011; Konstruksioni financiar i projektit titulli projektit mandrica i datës 01.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit trashegimtari i datës 16.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit nuk ka i datës 18.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit Koshare i datës 10.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit sabria i datës 16.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit evropianët e rinjë i datës 13.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit shtëpia e fundit i datës 13.06.2011; konstruksioni financiar; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit ditari televiziv i datës 09.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit lili po i datës 13.06.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit nuk ka i datës 15.02.2011; Paralogaria financiare e projektit konstruksioni financiar i projektit titulli projektit film i animuar mesimi i datës 09.06.2011; Projektet konkurruese në konkursin e vitit 2010 datë 15.01.2010-24.02.2010 1/44 faqe; Projektet që kanë konkuruar për vitin 2009 1/5 faqe; Projektet 2009 vlerësimi i konstruksioneve financiare të filmave të gjitha llojeve ¼ faqe; Projektet filmike 2009 konstruksionet financiare të dorëzuara në QKK të datës 19.03.2009; Projektet filmike 2009 konstruksionet financiare të

dorëzuara në QKK të datës 12.03.2008; Projektet filmike 2009 operatorët që dorëzojnë projektet në QKK të datës 09.03.2009; Konstruksionet financiare të projekteve të vitit 2009 1/10 faqe; Konstruksionet financiare të projekteve shtator 2009 1/22 faqe të datës 07.04.2009 dhe 24.09.2009; Planet financiare të të gjitha metrazhave datë 28.05.2008; Kontrollimi i planeve financiare të të gjitha metrazhave filma të metrazhit të gjatë datë 02.06.2008; Filma dokumentarë datë 28.05.2008; Ankesë me numër protokolli 1637/2017 e datës 28.04.2017 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit; Kërkesë me numër protokolli 253/2017 i datës 13.04.2017; Përgjigje në kërkesë i datës 29.03.2017; Kërkesë për opinion ligjor nr.177/2017 e datës 13.03.2017; Vendim nr.97/2012 i datës 16.07.2012; Kontratë nga QKK për A.L. me numër protokolli 98/2012 i datës 16.07.2012; Raporti i shpenzimeve të QKK i datës 03.06.2014; Vendim i datës 26.08.2011; Kontratë nga QKK për D.H. i datës 26.08.2011; Kontratë nga QKK për L.C. i datës 26.08.2011; Vendim i datës 11.03.2010; Kontratë nga QKK për A.V. i datës 25.03.2010; Kontratë nga QKK për I.S. i datës 25.03.2009; Vendim i datës 06.05.2008; Kontratë nga QKK për M.S. i datës 28.05.2008; Kontratë nga QKK për A.V. i datës 28.05.2008; Llogaria e pagesës së faturave mbyllja e vitit 2009 e datës 22.11.2010; Llogaria e pagesës së faturave mbyllja e avanceve e datës 22.11.2010; Vendimi nr.193/2013 i datës 03.05.2013; Vendim nr.131/2016 i datës 05.08.2016; Kontratë nga QKK për V.P. i datës 13.09.2016; Kontratë nga QKK për F.Sh. i datës 13.09.2016; Kontratë nga QKK për D.M. i datës 13.09.2016; Përgjigje në ankesë i datës 03.08.2017; Procesverbal i Komisionit për Ankesa me numër protokolli 2350/2017 i datës 30.05.2017; Akt Emërim i R.R. i datës 25.09.2012; E-mail nga Sh.I. për R.R. i datës 29.05.2017; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 28.06.2017;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të Aktgjykimit A.nr.2026/2022 të datës 04.04.2025 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative dhe bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*..

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës ankuesi është i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 25.09.202012 në pozitën e punës “Financier” në Qendrën Kinematografike të Kosovës në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Ankuesi me datë 28.04.2017 me numër protokolli 1637/2017 ka bërë ankesë në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit me pretendimet ankimore që ti bëhet pagesa si anëtarë i Komisionit Financiar, sipas vendimeve të nxjerra nga Qendra Kinematografike e Kosovës për formimin e këtij Komisioni në vitet 2008 deri 2012. Ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit ka nxjerrë vendimin me numër protokolli 2320/2017 me datë 26.05.2017 përmes të cilit refuzohet në tërësi si jasht afatit ankesa me nr.1637/2017 e datës 28.04.2017 nga ankuesi.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit me datë 27.06.2017 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendimin me numër A02/374/2017 të datës 07.08.2017 ka Hedhë poshtë si të palejuar ankesën me numër protokolli 3156/2017 të datës 27.06.2017 e parashtruar nga ankuesi R.R

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokolli 2320/2017 të datës 26.05.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit përmes të cilit refuzohet në tërësi si jasht afatit ankesa me nr.1637/2017 e datës 28.04.2017 e parashtruar nga ankuesi. Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Vendimi me numër protokolli 2320/2017 i datës 26.05.2017 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit është nxjerrë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave përkatësisht nënin 8 paragrafi 2 i cili përcakton se: **2. Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës.** Si dhe bazuar në Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative përkatësisht nënin 130 paragrafi 130.1. cili përcakton se: **130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.** Andaj si rrjedhojë e kësaj Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar vendimin e lartëcekur ka ardhë në përfundim se pretendimet e ankuesit lidhur me pagesën shpërblimin e tij në cilësinë e anëtarit të Komisionit Financiar të Qendrës Kinematografike të Kosovës që kanë të bëjnë për vitet 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012 kanë qenë jashtë afatit kohor

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 2320/2017 të datës 26.05.2017 ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendim.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.13/2020

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit R.R;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative,
Gjyqtarës Rajmonda Kurteshi;
- Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit (Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore);
si dhe Arkivit të KPMSHCK-së